



REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT	
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE	
ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. Dep. Dep.	Nr. Prot. Br. Prot. Prot. No.
2-D/DPK	01-3195/15
Nr. itaq.	Data
02	12-10-2015
Broj. stranica	Datum
Nr. pages	Date
PRISHTINE	



Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosovo

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Në mbështetje të nenit 11 (paragrafi 1.1), nenit 5 (paragrafi 1 pika 1.5), nenit 18 (paragrafi 10 dhe 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenit 19 (paragrafi 11) të Rregullores nr. 01/2014 së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 06.10.2015, mori:

V E N D I M

I. Mbyllet rasti me nr. AKK-03-02-1212/15, për zyrtarin e lartë z. Veton Nurkollari, Kryetar i Këshillit Drejtues të Qendrës Kinematografike të Kosovës për shkak se zyrtari i lartë publik ka dhen dorëheqje nga pozita e Kryetarit të Këshillit Drejtues të Qendrës Kinematografike të Kosovës .

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

I. Në rastin e shqyrtuar për konflikt të interesit me numër protokolli AKK-03-02-1212/15, që për trajtim ka pasur zyrtarin e lartë z. Veton Nurkollari, Kryetar i Këshillit Drejtues të Qendrës Kinematografike të Kosovës janë zhvilluar procedurat e parapara duke filluar nga : vlerësimi i informatave të deponuar ku thuhej se zyrtari i lartë z. Veton Nurkollari gjatë kohës se ushtrimit të funksionit publik si zyrtar i lartë është i angazhuar edhe në veprimtari tjera private e qe është në kundërshtim me ligjin në fuqi .

Pas zhvillimit të procedurave të parapara lidhur me këtë rast zyrtari i lartë z. Veton Nurkollari, Kryetar i Këshillit Drejtues të Qendrës Kinematografike të Kosovës është vërtetuar se gjatë kohës se ushtrimit të funksionit publik është i angazhuar në veprimtari private si Drejtor Artistik në Organizatën Jo Qeveritare “Doku-Fest” me nr. Regjistrimi 5102107-0, e që sipas Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik Nr.04/L- 051 kjo situatë paraqet kufizim në ushtrimin e funksionit publik e qe mundë të sjell konflikt të interesit, andaj Agjencia kundër Korrupsionit me datën 14.08.2015 e ka njoftuar zyrtarin e lartë me shkresën e

parë se ka filluar procedura e shqyrtimit të gjendjes së mundshme të Konfliktit të Interesit dhe se ka të drejtë në afatin prej 15 ditësh të njoftohet me faktet që posedon Agjencia.

Pas kësaj shkrese z. Veton Nurkollari ka kontaktuar me zyrtarët e AKK-së, dhe është interesuar që të informohet me gjerësisht me çështjen e ngritur.

Me datën 20.08.2015 është mbajtur takimi me z. Veton Nurkollari ku i janë prezantuar faktet që lidhen me çështjen e ngritur për kufizimin e zyrtarit të lartë gjatë ushtrimit të funksionit publik si Kryetar i Këshillit Drejtues të Qendrës Kinematografike të Kosovës krahas angazhimit në veprimtarive private.

Gjatë takimit z. Veton Nurkollari është arsyetuar se nuk ka qenë në dijeni se angazhimi në një OJQ-ë gjatë kohës sa ushtron funksion publik mundë të ketë ndoni kufizim apo papajtueshmëri, mirë po nga zyrtarët e AKK-së është njoftuar me dispozitat ligjore që e rregullojnë këtë çështje që lidhet me funksione menaxhuese në veprimtari private krahas funksionit publik.

Zyrtari i lartë z. Veton Nurkollari gjatë këtij takimi ka theksuar se është i gatshëm të pranoj çfarë do rekomandimi që nxjerr Agjencia duke thene se nuk ka qenë i informuar lidhur me këtë çështje dhe nuk dëshiron në asnjë momente të jetë në kundërshtim me ligjin.

Agjencia kundër Korrupsionit me datën 08.09.2015 i ka dërguar njoftimin paralajmërues zyrtarit z. Veton Nurkollari ku e ka njoftuar me konstatimin lidhur me situatën e kufizimit që sjellë konflikt të Interesit.

Me datën 30.09.2015 kemi marr njoftimin zyrtar nga Ministria e Kulturës Rinis dhe Sporteve ku jemi njoftuar se zyrtari i lartë z. Veton Nurkollari – Kryetar i Këshillit Drejtues të Qendrës Kinematografike të Kosovës ka dhënë dorëheqje nga funksioni i Kryetarit të Këshillit Drejtues të Qendrës Kinematografike të Kosovës.

Duke analizuar veprimet e ndërmarra nga zyrtarit i lartë z. Veton Nurkollari, pas dorëheqjes nga funksioni i Kryetarit të Këshillit Drejtues të Qendrës Kinematografike të Kosovës dhe pasi janë krijuar rrethana të reja konsiderojmë se është shmangur gjendjen e mundshme e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik, andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

II. Në mbështetje të nenit 18 (paragrafi 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja,

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik
- Drejtorit të DPK- së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)
- Z./znj. (zyrtari kontaktues)

Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit,

